



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**ZL.Anr.79/2025**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova - kryesuese, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat nga subjekti politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak (SPO), me seli në Komunën Graqanicë, të paraqitur kundër, subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më 01.10.2025, merr këtë:

**V E N D I M**

**HEDHEN TË PASAFATSHME** ankesat ZL.Anr.79/2025, ZL.Anr.80/2025, ZL.Anr.81/2025, ZL.Anr.82/2025, dhe ZL.Anr.83/2025 të datës 29.09.2025 të paraqitura nga subjekti politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak (SPO), me seli në Komunën Graqanicë, kundër subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025.

**A r s y e t i m**

Me datë 29.09.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesat ZL.Anr.79/2025, ZL.Anr.80/2025, ZL.Anr.81/2025, ZL.Anr.82/2025, dhe ZL.Anr.83/2025 nga subjekti politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak (SPO), me seli në Komunën Graqanicë, ku në ankesën ZL.Anr.79/2025, pretendon se aktivistët e subjektit politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak, më 26.09.2025, duke mbikëqyrur aktivitetet e subjekteve të tjera politike, vunë re se përkrahësit e subjektit politik Lista Serbe në territorin e komunës së Mitrovicës Veriore, në disa lokacione (fotografi të bashkangjitura), kanë ngjitur afisha në vende të paautorizuara në rrugën Lole Ribar dhe rrugën I Kralja Petra, siç janë ndërtesat, hyrjet në ndërtesa, lokalet publike dhe i gjithë qendra e Mitrovicës Veriore, gjë që është në kundërshtim me kodekset ligjore të subjekteve politike që përdorin objekte për promovim dhe kanë shkelur rregullat e fushatës zgjedhore, duke qenë se ngjitën afisha në vende që nuk parashikohen për këtë qëllim. Në bazë të dispozitave ligjore në fuqi që lidhen me ciklin zgjedhor dhe rregullat, duke qenë se shkelja është kryer më 26.09.2025 në orën 13:00, ne kërkojmë nga PZAP të pranojë ankesën si të bazuar dhe të dënohet subjekti politik Lista Serbe



- Zlatan Elek në përputhje me normat dhe rregullat ligjore që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore.

Në ankesën ZL.Anr.80/2025, nga pala ankuese pretendohet se aktivistet e subjektit politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak, me datë 24.09.2025, gjatë mbikëqyrjes së aktiviteteve të subjekteve të tjerë politikë, vunë re se përkrahësit e subjektit politik Lista Serbe në territorin e komunës Zubin Potok në disa lokacione (fotografitë e bashkangjitura) kishin ngjitur afisha në vende të paautorizuara, siç janë ndërtesa, vendet për reklama komerciale, bandera, stacionet e autobusëve, lokale, gjë që është në kundërshtim me kodekset ligjore për subjektet politike që përdorin objekte për promovim dhe kanë shkelur rregullat e fushatës zgjedhore, duke qenë se ngjiten afisha në vende që nuk parashikohen për këtë qëllim. Në bazë të dispozitave ligjore në fuqi që kanë të bëjnë me ciklin zgjedhor dhe rregullat, duke qenë se shkelja është kryer me 24.09.2025 në orën 13:00, kërkojmë nga PZAP të pranojë ankesën si të bazuar dhe të dënohet subjekti politik Lista Serbe - Zlatan Elek në përputhje me normat dhe rregullat ligjore që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore.

Në ankesën ZL.Anr.81/2025, nga pala ankuese, aktivistët e subjektit politik Za slobodu Pravdu i Opstanak, me datë 21.09.2025, gjatë mbikëqyrjes së aktiviteteve të subjekteve të tjerë politikë, vunë re se përkrahësit e subjektit politik Lista Serbe në territorin e komunës Leposavicë, në disa lokacione (fotografitë e bashkangjitura) në vendbanimet Lešak, Leposaviq, Soçanicë, Ibarska Slatina, kishin ngjitur afisha në vende të paautorizuara, siç janë objektet publike, stacionet e autobusëve, stacioni i autobusëve në Leposaviq, bandera, vendet për reklama komerciale, objektet për sinjalizim, objektet brenda oborreve shkollore dhe në vendin e votimit në Leposaviq, gjë që është në kundërshtim me kodekset ligjore për subjektet politike që përdorin objekte për promovim dhe kanë shkelur rregullat e fushatës zgjedhore, duke qenë se ngjiten afisha në vende që nuk parashikohen për këtë qëllim. Në bazë të dispozitave ligjore në fuqi që kanë të bëjnë me ciklin zgjedhor dhe rregullat, duke qenë se shkelja është kryer me 21.09.2025 në orën 11:00, kërkojmë nga PZAP të pranojë ankesën si të bazuar dhe të dënohet subjekti politik Lista Serbe - Zlatan Elek në përputhje me normat dhe rregullat ligjore që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore.

Në ankesën ZL.Anr.82/2025, nga pala ankuese Aktivistët e subjektit politik Za slobodu Pravdu i Opstanak, me datë 21.09.2025, gjatë mbikëqyrjes së aktiviteteve të subjekteve të tjerë politikë, vunë re se përkrahësit e subjektit politik Lista Serbe në territorin e komunës Shtërpce, në disa lokacione (fotografitë e bashkangjitura) në vendbanimet Shtërpce, Sevec, Jazincë, Brezovicë, kishin ngjitur afisha në vende të paautorizuara, siç janë objektet publike, stacionet e autobusëve, bandera, gardhet e institucioneve publike, lokale pranë rrugës, gjë që është në kundërshtim me kodekset ligjore për subjektet politike që përdorin objekte për promovim dhe kanë shkelur rregullat e fushatës zgjedhore, duke qenë se ngjiten afisha në vende që nuk parashikohen për këtë qëllim. Në bazë të dispozitave ligjore që janë në fuqi dhe kanë të bëjnë me ciklin zgjedhor dhe rregullat, duke qenë se shkelja është kryer me 21.09.2025 në orën 15:00, kërkojmë nga PZAP të pranojë ankesën si të bazuar dhe të dënohet subjekti politik Lista Serbe - Zlatan Elek në përputhje me normat dhe rregullat ligjore që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore.



Në ankesën ZL.Anr.83/2025, nga pala ankuese Aktivistët e subjektit politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak, me datë 22.09.2025, gjatë mbikëqyrjes së aktiviteteve të subjekteve të tjerë politikë, vunë re se përkrahësit e subjektit politik Lista Serbe në territorin e komunës Gračanica në disa lokacione (fotografitë e bashkangjitura) ngjitën afisha në vende të paautorizuara në rrugën drejt vendit kryesor të votimit në O.S. Kralja Milutin (më pak se 100 metra), gjë që është në kundërshtim me kodekset ligjore për subjektet politike që përdorin objekte për promovim dhe kanë shkelur rregullat e fushatës zgjedhore, duke qenë se ngjitën afisha në vende që nuk parashikohen për këtë qëllim. Njëkohësisht, në rrugën kryesore Cara Lazara (rrugë magjistrale Gjilan-Prishtinë) ngjitën afisha të Lista Serbe në vende komerciale për reklama, ndërsa normalisht bilbordet ndodhen në sipërfaqe publike pranë rrugës. Shkelja e tretë është se në rrugën që çon në spitalin kryesor, në objektin "Vocara", gjithashtu ngjitën afisha (fotografitë e bashkangjitura). Në bazë të dispozitave ligjore që janë në fuqi dhe kanë të bëjnë me ciklin zgjedhor dhe rregullat, duke qenë se shkelja është kryer me 22.09.2025 në orën 13:00, kërkojmë nga PZAP të pranojë ankesën si të bazuar dhe të dënohet subjekti politik Lista Serbe - Zlatan Elek në përputhje me normat dhe rregullat ligjore që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore.

Në përgjigjen në ankesë lidhur rastin ZL.Anr 79/2025, nga subjekti politik Srpska Lista, theksohet se më datë 29.09.2025, Nenad Rašić ka parashtruar ankesën nr. Anr.79/2025 në orën 15:30, me të cilën pretendon se aktivistët e subjektit të tij politik kanë vënë re më 26.09.2025 në orën 15:00 se mbështetësit e subjektit politik Lista Serbe kanë ngjitur postera në vende të banimit kolektiv dhe kanë shkelur Rregullat Zgjedhore në lidhje me vendosjen e materialit promovues të Listes Serbe në territorin e Komunës së Mitrovicës së Veriut, para së gjithash, ankesa nuk është parashtruar në kohën e duhur nga Nenad Rašić, pra brenda afatit prej 48 orësh nga momenti i shkeljes së supozuar, pasi Rašić në ankesë ka shkruar se aktivistët e tij e kanë vënë re këtë më 26 Shtator në orën 15:00, dhe ankesa është dorëzuar 3 ditë më vonë, duke shkelur kështu Rregullën Zgjedhore nr. 1/2025, konkretisht neni 9, paragrafi 5, i cili thotë se afati për parashtrimin e ankesës në lidhje me shkeljen e kodit të sjelljes së subjekteve politike, mbështetësve dhe kandidatëve të tyre është 48 orë. Gjithashtu, kjo ankesë nuk është e vërtetë dhe nuk korrespondon me faktet, sepse Lista Serbe ka vendosur postera promovues në objekte të banimit kolektiv në përputhje me nenin 7, paragrafin 2.6 të Rregullës Zgjedhore nr. 7/2024. Pëlqimin dhe deklaratat e banorëve të këtyre objekteve e bashkëngjitem si shtojcë.

Në përgjigjen në ankesë lidhur rastin ZL.Anr 80/2025, nga subjekti politik Srpska Lista, thekson se më datë 29.09.2025, Nenad Rašić ka parashtruar ankesën nr. Anr.80/2025 në orën 15:30, me të cilën pretendon se aktivistët e subjektit të tij politik kanë vënë re më 24.09.2025 se mbështetësit e subjektit politik Lista Serbe kanë ngjitur postera në vende të banimit kolektiv dhe kanë shkelur Rregullat Zgjedhore në lidhje me vendosjen e materialit promovues të Srpska lista në territorin e Komunës së Zubin Potokut., para së gjithash, ankesa nuk është parashtruar në kohën e duhur nga Nenad Rašić, pra brenda afatit prej 48 orësh nga momenti i shkeljes së supozuar, pasi Rašić në ankesë ka shkruar se aktivistët e tij e kanë vënë re këtë më 24 Shtator në orën 13:00, dhe ankesa është dorëzuar 5 ditë më vonë, duke shkelur kështu Rregullën Zgjedhore nr. 1/2025, konkretisht neni 9, paragrafi 5, i cili thotë se afati për parashtrimin e ankesës në lidhje me shkeljen e kodit të sjelljes së subjekteve politike, mbështetësve dhe kandidatëve të tyre është 48 orë. Gjithashtu, kjo ankesë nuk është e vërtetë dhe nuk



korrespondon me faktet, sepse Lista Serbe ka vendosur postera promovues në objekte të banimit kolektiv në përputhje me nenin 7, paragrafin 2.6 të Rregullës Zgjedhore nr. 7/2024. Pëlqimin dhe deklaratat e banorëve të këtyre objekteve e bashkëngjitem si shtojcë.

Në përgjigjen në ankesë lidhur rastin ZL.Anr 81/2025, se më datë 29.09.2025, Nenad Rašić ka parashtruar ankesën nr. Anr.81/2025 në orën 15:33, me të cilën pretendon se aktivistët e subjektit të tij politik kanë vënë re më 21.09.2025 se mbështetësit e subjektit politik Lista Serbe kanë ngjitur postera në vende të paautorizuara dhe kanë shkelur Rregullat Zgjedhore në lidhje me vendosjen e materialit promovues të Lista Serbe në territorin e Komunës së Leposaviqit, saktësisht në vendet Leshak, Leposaviq, Soqanicë dhe Slatina e Ibrit. Para së gjithash, ankesa nuk është parashtruar në kohën e duhur nga Nenad Rašić, pra brenda afatit prej 48 orësh nga momenti i shkeljes së supozuar, pasi Rašić në ankesë ka shkruar se aktivistët e tij e kanë vënë re këtë më 21 Shtator, dhe ankesa është dorëzuar 8 ditë më vonë, duke shkelur kështu Rregullën Zgjedhore nr. 1/2025, konkretisht neni 9, paragrafi 5, i cili thotë se afati për parashtrimin e ankesës në lidhje me shkeljen e kodit të sjelljes së subjekteve politike, mbështetësve dhe kandidatëve të tyre është 48 orë.

Në përgjigjen në ankesë lidhur rastin ZL.Anr 82/2025, theksohet se me datë 29.09.2025, Nenad Rašić ka parashtruar ankesën nr. Anr.82/2025 në orën 15:33, me të cilën pretendon se aktivistët e subjektit të tij politik kanë vënë re më 21.09.2025 se mbështetësit e subjektit politik Lista Serbe kanë ngjitur postera në vende të paautorizuara dhe kanë shkelur Rregullat Zgjedhore në lidhje me vendosjen e materialit promovues të Lista Serbe në territorin e Komunës së Shtërpces. Para së gjithash, ankesa nuk është parashtruar në kohën e duhur nga Nenad Rašić, pra brenda afatit prej 48 orësh nga momenti i shkeljes së supozuar, pasi Rašić në ankesë ka shkruar se aktivistët e tij e kanë vënë re këtë më 21 Shtator në ora 15:00, dhe ankesa është dorëzuar 8 ditë më vonë, duke shkelur kështu Rregullën Zgjedhore nr. 1/2025, konkretisht neni 9, paragrafi 5, i cili thotë se afati për parashtrimin e ankesës në lidhje me shkeljen e kodit të sjelljes së subjekteve politike, mbështetësve dhe kandidatëve të tyre është 48 orë.

Në përgjigjen në ankesë lidhur rastin ZL.Anr 83/2025, theksohet se më datë 29.09.2025, Nenad Rašić ka parashtruar ankesën nr. Anr.83/2025 në orën 15:35, me të cilën pretendon se aktivistët e subjektit të tij politik kanë vënë re më 22.09.2025 se mbështetësit e subjektit politik Lista Serbe kanë ngjitur postera dhe kanë shkelur Rregullat Zgjedhore në lidhje me vendosjen e materialit promovues të Lista Serbe në territorin e Komunës së Graqanicës. Kjo ankesë nuk është parashtruar në kohën e duhur nga Nenad Rašić, pra brenda afatit prej 48 orësh nga momenti i shkeljes së supozuar, pasi Rašić në ankesë ka shkruar se aktivistët e tij e kanë vënë re këtë më 22 Shtator në ora 13:00, dhe ankesa është dorëzuar 7 ditë më vonë, duke shkelur kështu Rregullën Zgjedhore nr. 1/2025, konkretisht neni 9, paragrafi 5, i cili thotë se afati për parashtrimin e ankesës në lidhje me shkeljen e kodit të sjelljes së subjekteve politike, mbështetësve dhe kandidatëve të tyre është 48 orë.

Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka



bashkuar ankesat ZL.Anr.79/2025, ZL.Anr.80/2025, ZL.Anr.81/2025, ZL.Anr.82/2025, dhe ZL.Anr.83/2025 të datës 29.09.2025, të njëjtat janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë e përbashkët ZL.A.nr.79/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

Paneli, pasi që shqyrtoj te gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

**- Ankesat janë të pasafatshme.**

Paneli, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore ka gjetur se ankesat e parashtruar nga subjekti politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak (SPO), me seli në Komunën Graçanicë, të paraqitura kundër subjektit politik Lista Serbe, në territorin e komunës së Mitrovicës së Veriut, komunës së Zubin Potok, komunës së Leposaviq, komunës së Shtërpçë dhe në komunën e Graçanicës, është pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 39 paragrafi 3 i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet në Kosovë, në të cilin nen në mënyrë decitive thuhet se: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, mund të paraqes ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe PZAP-i, do të vendos për ankesën brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga koha e pranimit të saj”*, si dhe neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosies së Ankesave të PZAP-it, në të cilin nen në mënyrë decitive thuhet se *“PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim”*, nën paragrafi 3.2. *“nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor”*.

Me dispozitën e nenit 9 paragrafi 5 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosies së Ankesave, parashihet që: *“Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara”*, ndërsa nën paragrafi 5.5 parashihet që: *“për shkeljet e pretenduara të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët”*.

Pra, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se, ankesat janë parashtruar, pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesave, sipas nenit 39, paragrafi 3 i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet në Kosovë, ku afati për dorëzimin e ankesave është 48 orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar. Në rastin konkret nga provat e prezantuara nga pala ankuese lidhur me ankesat, përkatësisht ankesën ZL.Anr.79/2025 shkelja e supozuar ka ndodhur me datë 26.09.2025 në orën 13:00, ndërsa ankesa është dorëzuar në PZAP më datë 29.09.2025, lidhur me ankesën ZL.Anr.80/2025 shkelja e supozuar ka ndodhur me datë 24.09.2025 në orën 13:00, ndërsa ankesa është dorëzuar në PZAP më datë 29.09.2025, lidhur me ankesën ZL.Anr.81/2025 shkelja e supozuar ka ndodhur me datë 21.09.2025 në orën 11:00, ndërsa ankesa është dorëzuar në PZAP më datë 29.09.2025, lidhur me ankesën ZL.Anr.82/2025 shkelja e supozuar ka ndodhur me datë 21.09.2025 në orën 15:00, ndërsa ankesa është dorëzuar në PZAP më datë 29.09.2025 lidhur me ankesën ZL.Anr.83/2025 shkelja e supozuar ka ndodhur me datë 22.09.2025 në orën 13:00,

ndërsa ankesa është dorëzuar në PZAP më datë 29.09.2025, që do të thotë se të gjitha ankesat në fjalë janë të paraqitura pas afatit ligjor, me çka vërtetohet se ankesat e ankuesit janë paraqitur pas afatit ligjor prej 48 orësh.

Paneli ka gjetur se që të gjitha ankesat janë parashtruar pas afatit të paraparë ligjor, dhe duke u bazuar në nenin 39, paragrafi 3 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet në Kosovë, dhe nenet 9 paragrafi 5 dhe 13 paragrafi 3 pika 3.2 të Rregullës 01/2025 për Procedurat e Parashtrimin dhe Vendorsjes së Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.79/2025 datë 01.10.2025

Kryesuesë e Panelit  
Violeta Husaj Rugova



*Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet në Kosovë, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimin të këtij vendimi*